FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 185

Tiranë – E mërkurë, 26 gusht 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. 602, datë 5.8.2026	"Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 20, datë 17.1.2025 "Për miratimin e kritereve për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar tek të rriturit dhe fëmijët dhe metodologjinë e rishikimit të tyre"	18457
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 841, datë 19.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Spanjës.....	18457
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 844, datë 20.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Hungarisë.....	18459
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 845, datë 20.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Spanjës.....	18462
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 847, datë 21.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE), të shfaqur në shtetin e Mbretërisë së Bashkuar.....	18464
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 848, datë 21.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Rumanisë.....	18466
Urdhër i Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave nr. 1072, datë 25.8.2026	Për miratimin e formularëve të deklarimit të interesave privatë.....	18467

Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 924/9, datë 25.8.2026

"Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtim i Nyjes që lidh rrugën e Laknasit me projektin "Zgjerimi i superstradës Tiranë-Durrës"..... 18537

UDHËZIM
Nr. 602, datë 5.8.2026

"PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 20, DATË 17.2025 "PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR VLERËSIMIN BIO-PSIKO-SOCIAL TË AFTËSISË SË KUFIZUAR TEK TË RRITURIT DHE FËMIJËT DHE METODOLOGJINË E RISHIKIMIT TË TYRE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të pikës 2 të kreut III, të vendimit nr. 722, datë 11.11.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 20, datë 17.1.2025, "Për miratimin e kritereve për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar tek të rriturit dhe fëmijët dhe metodologjinë e rishikimit të tyre", bëhen këto ndryshime:

1. Në Kriteret e Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar tek të Rriturit, në kapitullin "Dëmtimet Psikiatrike", në frekuencat e kërkuara të vlerësimit, bëhen këto ndryshime:

a) Prapambetja mendore e moderuar ICD 10-15: F71.9, togfjalëshi "Vlerësimi bëhet çdo dy vjet. Nëse vuan nga sëmundje të tjera bashkëshoqëruese psikiatrike ose sëmundje mjekësore të përgjithshme, çdo 5 vjet" zëvendësohet me "Vlerësimi bëhet 1 herë në 5 vjet".

b) Prapambetja mendore e rëndë ICD 10-15: F72.9, togfjalëshi "Nëse vuan nga sëmundje të tjera bashkëshoqëruese psikiatrike ose sëmundje mjekësore të përgjithshme, rivlerësimi bëhet çdo 10 vjet" zëvendësohet me "Vlerësimi bëhet 1 herë në 10 vjet".

c) Prapambetja mendore e thellë ICD 10-15: F73.9, togfjalëshi "Frekuenca e kërkuar e vlerësimit është çdo 10 vjet, prapambetja e rëndë dhe e thellë mund të jetë ose pa afat" zëvendësohet me "Vlerësimi bëhet 1 herë në 10 vjet ose pa afat".

ç) Çrregullim i spektrit të autizmit ICD 10-15: F84.0, pas togfjalëshit "...edhe mbi 10 vjet" shtohet togfjalëshi "ose pa afat".

2. Në Kriteret e Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar tek fëmijët, në kapitullin "Dëmtimet Psikiatrike", në frekuencat e kërkuara të vlerësimit, bëhen këto ndryshime:

a) Prapambetja mendore e moderuar ICD 10-15: F71, togfjalëshi "1 herë në 3 vjet" zëvendësohet me "1 herë në 5 vjet".

b) Prapambetja mendore e rëndë ICD 10-15: F72, togfjalëshi "Çdo 5 vjet" zëvendësohet me "1 herë në 10 vjet".

c) Prapambetja mendore e thellë ICD 10-15: F73, togfjalëshi "1 herë në 5 vjet" zëvendësohet me "1 herë në 10 vjet".

d) Çrregullim i spektrit të autizmit ICD 10-15: F84.0, në frekuencën e kërkuar të vlerësimit, togfjalëshi "1 herë në 3 vjet" zëvendësohet me "1 herë në 5 vjet".

3. Ngarkohet Shërbimi Social Shtetëror, Komisioni Shumëdisiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, strukturat e shërbimit shëndetësor parësor dhe dytësor, Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor dhe Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për fëmijët, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MIRËQENIES SOCIALE
Evis Sala

URDHËR
Nr. 841, datë 19.8.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË SHFAQUR NË SHTETIN E SPANJËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Spanjës, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja Administrative e Nivelit të Parë	Ndarja Administrative e Nivelit të Dytë	Ndarja Administrative e Nivelit të Tretë*
Aragón	Huesca	Boltaña*
Cataluña	Girona	Pla de l'estany (banyoles)*
Castilla y León	Segovia	Segovia*
Castilla - La Mancha	Toledo	Galvez*
Castilla - La Mancha	Toledo	Toledo*
Castilla - La Mancha	Toledo	Oropesa*
Comunidad Foral de Navarra	Navarra	Ochagavia*
Extremadura	Badajoz	Don Benito*
País Vasco	**Araba/Álava**	**Araba-Alava***
País Vasco	Gipuzkoa	Gipuzkoa*
Illes Balears	Illes Balears	Palma*
Illes Balears	Illes Balears	Menorca*
Galicia	A Coruña	Ferrol*
Galicia	A Coruña	A Barcala*
Galicia	Lugo	Meira*
La Rioja	La Rioja	Alfaro*

Shënime: Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës, dhe;

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë Culicoides në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, ose;

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë Culicoides në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët, ose;

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë Culicoides në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipeve të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar, ose;

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipeve të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes, dhe;

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës, ose;

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë, ose;

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve in vivo së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes, dhe;

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve, ose;

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative, ose;

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjithë kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 826, datë 13.8.2026 "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së Gjuhës Blu të shfaqur në shtetin e Spanjës", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Tana Kika

URDHËR
Nr. 844, datë 20.8.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përjashtuar mishin në një kontenier të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja Administrative e Nivelit 1	Ndarja Administrative e Nivelit 2	Ndarja Administrative e Nivelit 3
Baranya	**Mohács***	
Baranya	Sellye*	
Somogy	Barcs*	
Szabolcs-Szatmár-Bereg	Mátészalka*	

Shënime: Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Hungarisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, ose;

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara in vivo të derrave të butë, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4. Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre,

materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhri nr. 829, datë 14.8.2026 "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin Hungarisë", shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Tana Kika

URDHËR
Nr. 845, datë 20.8.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË SHFAQUR NË SHTETIN E SPANJËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Spanjës, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja Administrative e Nivelit të Parë	Ndarja Administrative e Nivelit të Dytë	Ndarja Administrative e Nivelit të Tretë*
Aragón	Huesca	Boltaña*
Cataluña	Girona	Pla de l'estany (banyoles)*
Castilla y León	Segovia	Segovia*
Castilla - La Mancha	Toledo	Galvez*
Castilla - La Mancha	Toledo	Toledo*
Castilla - La Mancha	Toledo	Oropesa*
Comunidad Foral de Navarra	Navarra	Ochagavia*
Extremadura	Badajoz	Don Benito*
País Vasco	Araba/Álava	Araba-Alava*
País Vasco	Gipuzkoa	Gipuzkoa*
Illes Balears	Illes Balears	Palma*
Illes Balears	Illes Balears	Menorca*
Galicia	A Coruña	Ferrol*
Galicia	A Coruña	A Barcala*
Galicia	**Lugo**	**Chantada***
Galicia	Lugo	Meira*
La Rioja	La Rioja	Alfaro*

Shënime: Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës, dhe;

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë Culicoides në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, ose;

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë Culicoides në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët, ose;

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë Culicoides në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipeve të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar, ose;

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipeve të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes, dhe;

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës, ose;

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë, ose;

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes, dhe;

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve, ose;

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative, ose;

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjithë kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 841, datë 19.8.2026 "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së Gjuhës Blu të shfaqur në shtetin e Spanjës", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Tana Kika

URDHËR
Nr. 847, datë 21.8.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË ENCEFALOPATISË SPONGIFORME TË GJEDHIT (BSE), TË SHFAQUR NË SHTETIN E MBRETËRISË SË BASHKUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1 të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit gjedh;

b) mishit të freskët dhe produkteve të mishit;

c) miellit proteinik me origjinë nga kafshët e llojit gjedh ose çdo produkt që përmban një material të tillë, që kanë origjinë nga një vend, zonë apo ndarje (kompartment) që paraqet rrezik të kontrolluar për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) ose rrezik të papërcaktuar për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE).

ç) gjaku dhe produktet e gjakut të marra nga kafshët e llojit gjedh;

d) dhjamit të shkrirë dhe derivatet e dhjamit;

dh) dikalcium fosfatit.

e) Ileumi distal nga gjedhët e çdo moshe, si dhe kafka, truri, sytë, shtylla kurrizore dhe palca kurrizore nga gjedhët që në momentin e therjes kanë qenë mbi 30 muajsh, ose çdo produkt i kontaminuar prej tyre, që kanë origjinë nga një vend, zonë apo ndarje (kompartment) që paraqet rrezik të papërcaktuar për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE), rrezik të kontrolluar për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE), nëse këto produkte rrjedhin nga gjedhë të lindur përpara datës nga e cila është provuar se rreziku i riciklimit të agjentit të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) në popullatën e gjedhit është bërë i papërfillshëm.

ë) Ushqim, ushqim për kafshë, plehra, produkte kozmetike, farmaceutike (përfshirë biologjike), pajisje mjekësore ose çdo produkt tjetër që përmban proteina të përgatitura duke përdorur materialet e përmendura në shkronjën e) të kësaj pike.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) të shfaqur në shtetin e Mbretërisë së Bashkuar janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja Administrative e Nivelit 1	Ndarja Administrative e Nivelit 2	Ndarja Administrative e Nivelit 3
1.	Scotland	North Ayrshire	North Ayrshire*

Shënime: Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të shtetit të Mbretërisë së Bashkuar të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit gjedh:

i) të përzgjedhur për eksport janë identifikuar përmes një sistemi identifikimi të kafshëve që mundëson gjurmimin e tyre gjatë gjithë jetës së tyre, dhe ose

ii) të përzgjedhur për eksport kanë lindur dhe janë mbajtur në një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm ose të kontrolluar të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) pas datës nga e cila rreziku i riciklimit të agjentëve të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) brenda popullatës së gjedhëve është treguar i papërfillshëm, ose

iii) të përzgjedhur për eksport, janë provuar se nuk janë ushqyer kurrë me miell proteinik të nxjerrë nga kafshët ripërtypëse.

b) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që:

i) kafshët e llojit gjedh nga i cili është nxjerrë mishi dhe produktet e mishit të freskët të jenë identifikuar përmes një sistemi identifikimi të kafshëve;

ii) kafshët e llojit gjedh i janë nënshtruar një inspektimi ante mortem me rezultate të favorshme;

iii) kafshët e llojit gjedh kanë lindur dhe janë mbajtur në:

- një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE); ose

- një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të kontrolluar të sëmundjes së encefalopatisë

spongiforme të gjedhit (BSE) pas datës nga e cila rreziku i riciklimit të agjentëve të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) brenda popullatës së gjedhit është treguar i papërfillshëm; ose

- një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të kontrolluar për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) para datës nga e cila rreziku i riciklimit të agjentëve për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) brenda popullatës së gjedhit është treguar i papërfillshëm, dhe mishi dhe produktet e mishit të freskët janë nxjerrë nga gjedhë që nuk i janë nënshtruar një procesi trullosjeje me një pajisje që injekton ajër të kompresuar ose gaz në zgavrën e kafkës, ose një procesi të pastrimit të palcës, ose ndonjë procedure tjetër që mund të kontaminojë gjakun me ind nervor, para therjes; dhe

- janë prodhuar dhe trajtuar në një mënyrë që siguron që produkte të tilla nuk përmbajnë dhe nuk janë të kontaminuara me mallrat e listuara në pikën 1 të Nenit 11.4.15. të Kodit Tokësor të WOAH ose mish i ndarë mekanikisht nga kafka ose nga kolona vertebrale e gjedhit mbi 30 muajsh.

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që:

i) kafshët e llojit gjedh nga të cilët është nxjerrë mielli proteinik janë identifikuar nëpërmjet një sistemi identifikimi të kafshëve dhe kanë lindur dhe janë mbajtur në një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE), dhe, ose

ii) kanë lindur pas datës nga e cila rreziku i riciklimit të agjentëve të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) brenda popullatës së gjedhëve është treguar i papërfillshëm; ose

iii) mielli proteinik është përpunuar në përputhje me Nenin 11.4.19. të Kodit Tokësor të WOAH përkatësisht:

- lënda e parë duhet të reduktohet në një madhësi maksimale grimcash prej 50 mm përpara ngrohjes dhe duhet të ngrohet në kushte avulli të ngopur në një temperaturë jo më të ulët se 133°C për një kohë minimale prej 20 minutash, në një presion absolut prej 3 bar; ose

- një procedurë alternative që është provuar se arrin të paktën një nivel të barasvlershëm reduktimi të infektivitetit të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE).

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që gjaku dhe produktet e gjakut janë:

i) janë nxjerrë nga gjedhë që janë identifikuar përmes një sistemi identifikimi të kafshëve dhe kanë lindur dhe janë mbajtur në një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm, ose në një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të kontrolluar të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) pas datës nga e cila rreziku i riciklimit të agjentëve të sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) brenda popullatës së gjedhit është treguar i papërfillshëm; ose

ii) mbledhur nga gjedhë që nuk i janë nënshtruar një procesi trullosjeje me një pajisje që injekton ajër të kompresuar ose gaz në zgavrën e kafkës, ose një procesi të pastrimit të palcës, ose ndonjë procedure tjetër që mund të kontaminojë gjakun me ind nervor, para therjes; dhe

iii) mbledhur dhe përpunuar në një mënyrë që siguron që ato të mos kontaminohen me ind nervor.

d) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që dhjami i shkrirë:

i) vjen nga një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE); ose

ii) rrjedh nga kafshë të llojit gjedhë që i janë nënshtruar një inspektimi ante mortem me rezultate të favorshme dhe nuk është përgatitur duke përdorur mallrat e listuara në pikën 1 të Nenit 11.4.15. të Kodit Tokësor të WOAH.

dh) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që derivatet e dhjamit:

i) e kanë origjinën nga një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE); ose

ii) nxirren nga dhjami që plotëson kushtet e përmendura në Nenin 11.4.16 të Kodit Tokësor të WOAH; ose

iii) janë prodhuar nga hidroliza, saponifikimi ose transesterifikimi që përdor temperaturë dhe presion të lartë.

e) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që dikalcium fosfati:

i) vjen nga një vend, zonë ose ndarje që paraqet një rrezik të papërfillshëm për sëmundjen e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE); ose

ii) është një bashkëprodukt i xhelatinës së kockave.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të kafshëve të gjalla të llojit gjedh, mishit të freskët dhe produkteve të mishit, miellit proteinik me origjinë nga kafshët e llojit gjedh ose çdo produkt që përmban një material të tillë, gjaku dhe produktet e gjakut të marra nga kafshët e llojit gjedh, dhjamit të shkrirë dhe derivatet e dhjamit, dikalcium fosfatit, ileumi distal nga gjedhët e çdo moshe, si dhe kafka, truri, sytë, shtylla kurrizore dhe palca kurrizore nga gjedhët që në momentin e therjes kanë qenë mbi 30 muajsh, ose çdo produkt i kontaminuar prej tyre, ushqim, ushqim për kafshë, plehra, produkte kozmetike, farmaceutike (përfshirë biologjike), pajisje mjekësore ose çdo produkt tjetër që përmban proteina të përgatitura që vijnë nga zonat e sipërcituara sipas pikes 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të çdo ngarkesë të kafshëve të gjalla të llojit gjedh, mishit të freskët dhe produkteve të mishit, miellit proteinik me origjinë nga kafshët e llojit gjedh ose çdo produkt që përmban një material të tillë, gjaku dhe produktet e gjakut të marra nga kafshët e llojit gjedh, dhjamit të shkrirë dhe derivatet e dhjamit, dikalcium fosfatit, ileumi distal nga gjedhët e çdo moshe, si dhe kafka, truri, sytë, shtylla kurrizore dhe palca kurrizore nga gjedhët që në momentin e therjes kanë qenë mbi 30 muajsh, ose çdo produkt i kontaminuar prej tyre, ushqim, ushqim për kafshë, plehra, produkte kozmetike, farmaceutike (përfshirë biologjike), pajisje mjekësore ose çdo produkt tjetër që përmban proteina të përgatitura, për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Tana Kika

URDHËR
Nr. 848, datë 21.8.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE DHIVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E RUMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e pikës 2.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Rumanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja Administrative e Nivelit 1	Ndarja Administrative e Nivelit 2
1.	Mureş	Voivodeni*
2.	Mureş	Vatava*
3.	Mureş	Zau De Campie*
4.	Mureş	Suseni*
5.	Buzău	Padina*
6.	Iaşi	Popesti*
7.	Tulcea	Murighiol*
8.	Vâlcea	Malaia*
9.	Gorj	Turcinesti*
10.	Constanţa	Istria*
11.	Gorj	Targu Jiu*
12.	Constanţa	Vulturu*
13.	**Tulcea**	**Peceneaga***

Shënime: Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të

Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Urdhëri nr. 831, datë 14.8.2026 "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Rumanisë", shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Tana Kika

URDHËR
Nr. 1072, datë 25.8.2026

PËR MIRATIMIN E FORMULARËVE TË DEKLARIMIT TË INTERESAVE PRIVATË

(Në sistemin elektronik të deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave-EACIDS)

Në mbështetje të nenit 4/2, nenit 21 dhe nenit 42/2, të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, si dhe të ligjit nr.23/2026, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike",

URDHËROJ:

1. Miratimin e formularëve të deklarimit të interesave privatë, sipas shtojcave që i bashkëlidhen këtij urdhri, si më poshtë:

- Deklarata e interesave privatë "Para Fillimit të Detyrës";
- Deklarata e interesave privatë "Periodike Vjetore";
- Deklarata e interesave privatë "Pas Largimit nga Funksioni";
- Deklarata e interesave privatë "Me Kërkesë";
- Deklarata e interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë.

2. Urdhri i Inspektorit të Përgjithshëm nr. 926, datë 29.10.2021, "Për miratimin e formularëve të deklarimit të interesave privatë (Në sistemin elektronik të deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave EACIDS", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
Evgjeni Bashari

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
Website: www.ildkpki.al, E-mail: info@ildkpki.al

Nr. Indeksi në ILDKPKI dhe Viti	

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATË PARA FILLIMIT TË DETYRËS

Plotësohet nga subjekti deklarues (zyrtari) që fillon punë në një nga funksionet që mbart detyrimin për deklarim të interesave privatë të tij, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë, në bazë të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 23, datë 3.2.2026 *"Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"*.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATË

Emri	Atësia	Mbiemri

Funksioni

Institucioni dhe adresa

Data e emërimit në detyrë	Data e dorëzimit të deklaratës

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar,

A u t o r i z o j:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI, që të verifikojnë në të gjitha subjektet privatë e publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.
Jap pëlqimin për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në sistemin e deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave – EACIDS, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Nënshkrimi i subjektit deklarues

"Para Fillimit të Detyrës"

TË DHËNA PERSONALE TË SUBJEKTIT DHE PERSONAVE TË LIDHUR

PËRBËRJA FAMILJARE E SUBJEKTIT SIPAS CERTIFIKATËS SË GJENDJES CIVILE

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr.Personal	Lidhja me deklaruesin	Gjendja Civile
					DEKLARUESI	

Adresa e plotë ku jeni të regjistruar në Gjendjen Civile:
(Njësia Administrative Nr. , Rruga, Pallati Nr., Bashki/Komunë)

Nëse dispononi vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banoni:	

Në kuadër të kufizimit të interesave private për shkak të konfliktit rast pas rasti apo të vazhdueshëm të interesit, në tabelën e mëposhtme deklarohen personat e lidhur që nuk pasqyrohen në certifikatën e gjendjes civile, si: bashkëjetuesi/bashkëjetuesja, si dhe fëmijët në moshë madhore dhe/ose të mitur që nuk janë pjesë e certifikatës familjare.

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr.Personal	Lidhja me deklaruesin	Gjendja Civile
					Bashkëjetuesi/ Bashkëjetuesja	
					I biri/e bija i/e ndarë nga trungu familjar	
					I biri/e bija i/e mitur	

Të dhënat në këtë faqe janë konfidenciale.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

"Para Fillimit të Detyrës"

DEKLARIMI I PASURIVE
DHE
BURIMI I KRIJIMIT

Të gjitha pasuritë e akumuluara ndër vite deri në datën e fillimit të detyrës, sipas gërmës a, b, c, ç, d * të nenit 4 dhe nenit 4/1 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil, të ndodhura brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të zotëruara nga zyrtari, apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë.

Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumën e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera	Pjesa në %

*** Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i Ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar:**

a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë, dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në Cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

* **Neni 4/1**. Subjekti deklarues që plotëson deklarimin për herë të parë, nuk mund të mbajë dhe të deklarojë gjendje në Cash jashtë sistemit bankar mbi shumën 1.5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve Cash mbi vlerën 1.5 (një presje pesë) milion lekë është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave privatë në ILDKPKI.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

"Para Fillimit të Detyrës"

**TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET
NË VEPRIMTARI
PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE**

Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; të subjektit, bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore, për periudhën nga data 1 janar deri në datën e fillimit të punës së vitit të deklarimit.

Përshkruani hollësisht çdo lloj angazhimi dhe veprimtarie që ka sjellë të ardhura, emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrit publik, statusi, objekti i veprimtarisë së organizatës, funksioni dhe/ose natyra e angazhimit nga 1 janari deri datën e fillimit të detyrës, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave neto të krijuara, në lekë apo në valutë

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

"Para Fillimit të Detyrës"

DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË

Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e fillimit në detyrë të subjektit deklarues, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.
Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve subjekti deklarues ka detyrime financiare, janë fusha konfidenciale.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë, për kreditë bankare shumën e kredisë (principalin), kohëzgjatjen (muajin/vitin)dhe këstin mujor, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e fillimit të detyrës.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

"Para Fillimit të Detyrës"

PERSONAT FIZIKË/JURIDIKË DHE PERSONAT E BESUAR

Të dhënat për personat fizikë e juridikë, duke përfshirë edhe personin e besuar, që rezultojnë të lidhur me zyrtarin që mbart detyrimin për deklarim, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.
Të dhënat për personat e besuar janë fusha konfidenciale.

Emër, Atësi, Mbiemër i individit, dhe/ose emërtimi i personit fizik dhe/ose atij juridik	Nr. personal/NIPT	Lidhja me deklaruesin	Lloji i interesave privatë, vendndodhja e tyre.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

"Para Fillimit të Detyrës"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
Website: www.ildkpki.al, E-mail: info@ildkpki.al

Nr. Indeksi në ILDKPKI

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATË E PERSONIT TË LIDHUR

Plotësohet dhe nënshkruhet nga personi i lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 22 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar, për pasuritë që disponohen veçmas.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATË

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar,

Autorizoj:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI, që të verifikojnë në të gjitha subjektet privatë e publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Shtetasi/ja _____,
Emër, Atësi, Mbiemër

bashkëshorti/ja ☐
fëmijë madhorë së bashku me prindërit ☐
fëmijë madhorë të ndarë nga prindërit ☐
bashkëjetuesi/ja ☐

i/e Subjektit _____,
Emër, Atësi, Mbiemër

Jap pëlqimin për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në sistemin e deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave – EACIDS, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Jam njohur me detyrimet që sanksionon legjislacioni në fuqi dhe deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore se:
Disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim/Nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

"Para Fillimit të Detyrës"

DEKLARIMI I PASURIVE
DHE
BURIMI I KRIJIMIT

Të gjitha pasuritë e akumuluara ndër vite deri në datën e fillimit të detyrës, sipas gërmës a, b, c, ç, d * të nenit 4 dhe nenit 4/1 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil, të ndodhura brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të zotëruara nga personi i lidhur me subjektin deklarues.

Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumën e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie*, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera	Pjesa në %

***Objekti i deklarimit** (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar)

a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale sipas Kodit Civil;
c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në Cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

* **Neni 4/1.** Subjekti deklarues që plotëson deklarimin për herë të parë, nuk mund të mbajë dhe të deklarojë gjendje në Cash, jashtë sistemit bankar, mbi shumën 1.5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve Cash mbi vlerën 1.5 (një presje pesë) milion lekë, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave privatë në ILDKPKI.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

"Para Fillimit të Detyrës"

TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET NË VEPRIMTARI PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE

Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimiprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; për periudhën nga data 1 janar deri në datën e fillimit të detyrës të subjektit deklarues.

Përshkruani hollësisht çdo lloj angazhimi dhe veprimtarie që ka sjellë të ardhura, emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrit publik, statusi, objekti i veprimtarisë së organizatës, funksioni dhe/ose natyra e angazhimit nga 1 janari deri datën e fillimit të detyrës së subjektit, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave neto të krijuara, në lekë apo në valutë

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

"Para Fillimit të Detyrës"

DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË

Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e fillimit të detyrës të subjektit deklarues, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.
Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve personi i lidhur ka detyrime financiare, janë fusha konfidenciale.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë, për kreditë bankare shumën e kredisë (principalin), kohëzgjatjen (muajin/vitin) dhe këstin mujor, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e fillimit të detyrës së subjektit

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

"Para Fillimit të Detyrës"

PERSONAT FIZIKË/JURIDIKË DHE PERSONAT E BESUAR

Të dhënat për personat fizikë e juridikë, duke përfshirë edhe personin e besuar, që rezultojnë të lidhur me personin e lidhur që mbart detyrimin për deklarim, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.
Të dhënat për personat e besuar janë fusha konfidenciale.

Emër, Atësi, Mbiemër i individit, dhe/ose emërtimi i personit fizik dhe/ose atij juridik	Nr. personal/NIPT	Lidhja me deklaruesin	Lloji i interesave privatë, vendndodhja e tyre.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

"Para Fillimit të Detyrës"

Informacion në ndihmën tuaj:

Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, interesave privatë, detyrimeve financiare të zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta, sanksionohet në ligjet mbi të cilat ushtron veprimtarinë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;

- Ligj nr. 9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar.
- Ligj nr. 23, datë 3.2.2026 *"Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"*.

Deklarimi i interesave privatë nga zyrtari (subjekti deklarues)

- Dokumenti zyrtar **"Deklaratë e interesave private para fillimit të detyrës"** duhet të plotësohet nga zyrtari që fillon punë në një nga funksionet që mbart detyrimin për deklarim, por edhe në rastet kur zyrtari ka patur ndërprerje për më tepër se një vit kalendarik nga funksioni i mëparshëm (nga deklarimi i fundit Pas Largimit).
- Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare.
- Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.
- **Formulari i deklarimit të interesave privatë, "Para fillimit të detyrës" duhet plotësuar në sistemin elektronik EACIDS, brenda 30 ditëve nga fillimi i detyrës, në përputhje me afatet e përcaktuara në ligj, si vijon:**
  - **<u>në formë elektronike,</u>** duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI, dhe;
  - **<u>në formë shkresore</u>,** në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë autoritetit përgjegjës të institucionit publik.

Deklarimi i interesave privatë nga personi i lidhur me zyrtarin (subjektin deklarues)

- Dokumenti zyrtar *"Deklaratë e interesave privatë e personit të lidhur"* duhet të plotësohet në sistemin elektronik EACIDS nga pjesëtarë të familjes (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit nenit 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, **për pasuritë që disponojnë veçmas** dhe plotësojnë formularin përkatës, si vijon;
  - **<u>në formë elektronike,</u>** duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI, dhe;
  - **<u>në formë shkresore</u>,** në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse.
- Subjekti/zyrtari nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e interesave privatë të personave të lidhur.

Sanksionet:

- Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 40 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.
- Për mosdeklarim para fillimit të detyrës, periodik vjetor, pas largimit nga funksioni apo me kërkesë, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, zyrtari ose personi i lidhur me të, që mbart detyrimin për deklarim, dënohet me gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.
- Refuzimi për deklarim nga zyrtari, sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me nenin 257/a të Kodit Penal.
- Refuzimi për deklarim nga personi i lidhur dënohet me gjobë dhe ndëshkohet sipas nenit 257/a të Kodit Penal
- Deklarimi i rremë apo fshehja e pasurisë përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

Kujdes: Të gjitha faqet e formularit të deklaratës duhet të nënshkruhen, në të kundërt deklarata do të kthehet dhe do të konsiderohet e padorëzuar në Inspektoratin e Lartë.

- Për informacione të mëtejshme, kontaktoni në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave me Sektorin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse, në numrin e telefonit **042 259 461** dhe/ose adresën e postës elektronike info@ildkpki.al.
- Të dhënat e deklaratës lejohet të publikohen sipas ligjit.

"Para Fillimit të Detyrës"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
Website: www.ildkpki.al, E-mail: info@ildkpki.al

Nr. Indeksi në ILDKPKI dhe Viti	

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATË
PERIODIK / VJETOR

Plotësohet nga subjekti deklarues (zyrtari) që mbart detyrimin për deklarim të interesave privatë të tij, të bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë, në bazë të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 23, datë 3.2.2026 *"Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"*.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATË

Emri	Atësia	Mbiemri

Funksioni

Institucioni dhe adresa

Data e emërimit në funksionin që kryen	Data e dorëzimit të deklaratës

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar,

A u t o r i z o j:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës -Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI, që të verifikojnë në të gjitha subjektet privatë e publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.
Jap pëlqimin për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në sistemin e deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave – EACIDS, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Nënshkrimi i subjektit deklarues

"Periodik/Vjetor"

TË DHËNA PERSONALE TË SUBJEKTIT DHE PERSONAVE TË LIDHUR

PËRBËRJA FAMILJARE E SUBJEKTIT SIPAS CERTIFIKATËS SË GJENDJES CIVILE

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr.Personal	Lidhja me deklaruesin	Gjendja Civile
					DEKLARUESI	

Adresa e plotë ku jeni të regjistruar në Gjendjen Civile:
(Njësia Administrative Nr., Rruga, Pallati nr., Bashki/Komunë)

Nëse dispononi vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banoni:	

Në kuadër të kufizimit të interesave private për shkak të konfliktit rast pas rasti apo të vazhdueshëm të interesit, në tabelën e mëposhtme deklarohen personat e lidhur që nuk pasqyrohen në certifikatën e gjendjes civile, si: bashkëjetuesi/bashkëjetuesja, si dhe fëmijët në moshë madhore dhe/ose të mitur që nuk janë pjesë e certifikatës familjare.

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr.Personal	Lidhja me deklaruesin	Gjendja Civile
					Bashkëjetuesi/ Bashkëjetuesja	
					I biri/e bija i/e ndarë nga trungu familjar	

Të dhënat në këtë faqe janë konfidenciale.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

"Periodik/Vjetor"

NDRYSHIMET E PASURIVE
DHE
BURIMI I KRIJIMIT

Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotëroni të çdo lloj pasurie*, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera	Pjesa në %

* **Objekti i deklarimit** (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar)

a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në Cash, jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

"Periodik/Vjetor"

TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET NË VEPRIMTARI PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE

Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; për periudhën nga data e deklarimit të mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit.

Përshkruani hollësisht të ardhurat brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura për subjektin, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë. Përcaktoni emërtimin e institucionit, organizatës apo aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrit publik, statusi, objektin e veprimtarisë së organizatës, funksionin, natyrën e angazhimit, nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave neto të krijuara, në lekë apo në valutë

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

"Periodik/Vjetor"

DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË

Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit, si dhe detyrimet e lindura për subjektin gjatë vitit të deklarimit, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.
Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve subjekti deklarues ka detyrime financiare, janë fusha konfidenciale.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë. Për kreditë bankare shumën e kredisë (principal), kohëzgjatjen (muaji/viti) dhe kësti mujor, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit (Principal + interes)	Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit (Principal)

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

"Periodik/Vjetor"

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Përshkruani hollësisht çdo lloj shpenzimi të deklarueshëm me vlerë mbi 300.000 lekë, si për arsim, mjekim, pushime, arredim e të tjera të këtij lloji, të kryera nga deklarimi i mëparshem deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.
Të dhënat për shpenzimet e deklarueshme janë fusha konfidenciale.

Përshkrimi i shpenzimeve	Shuma në lekë ose valutë të huaj

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

"Periodik/Vjetor"

DHURATA DHE TRAJTIME PREFERENCIALE

Përshkruani hollësisht llojin e dhuratës në vlerën mbi 10 000 (dhjetë mijë lekë), si dhe trajtime preferenciale, nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik. Të dhënat për dhuratat dhe trajtimet preferenciale janë fusha konfidenciale.	Identiteti i personit fizik ose juridik dhe lidhja e tij me zyrtarin.	Vlera e dhuratës /trajtimit preferencial në lekë ose valutë

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

PERSONAT FIZIKË/JURIDIKË DHE PERSONAT E BESUAR

Të dhënat për personat fizikë e juridikë, duke përfshirë edhe personin e besuar, që rezultojnë të lidhur me zyrtarin që mbart detyrimin për deklarim, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.
Të dhënat për personat e besuar janë fusha konfidenciale.

Emër, Atësi, Mbiemër i individit, dhe/ose emërtimi i personit fizik dhe/ose atij juridik	Nr. personal/NIPT	Lidhja me deklaruesin	Lloji i interesave privatë, vendndodhja e tyre.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
Website: www.ildkpki.al, E-mail: info@ildkpki.al

Nr. Indeksi në ILDKPKI	

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATË E PERSONIT TË LIDHUR

Plotësohet dhe nënshkruhet nga personi i lidhur me subjektin deklarues (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 22 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar, për pasuritë që disponohen veçmas.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATË

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar,

Autorizoj:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI, që të verifikojnë në të gjitha subjektet privatë e publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Shtetasi/ja _____,
Emër, Atësi, Mbiemër

bashkëshorti/ja ☐
fëmijë madhorë së bashku me prindërit ☐
fëmijë madhorë të ndarë nga prindërit ☐
bashkëjetuesi/ja ☐

i/e Subjektit _____,
Emër, Atësi, Mbiemër

Jap pëlqimin për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në sistemin e deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave – EACIDS, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Jam njohur me detyrimet që sanksionon legjislacioni në fuqi dhe deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore se:
Disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim/ Nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

"Periodik/Vjetor"

NDRYSHIMET E PASURIVE DHE BURIMI I KRIJIMIT

Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotëroni, të çdo lloj pasurie*, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera	Pjesa në %

***Objekti i deklarimit** (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar)

a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë, dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në Cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

"Periodik/Vjetor"

TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET NË VEPRIMTARI PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE

Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda ose jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; për periudhën nga data e deklarimit të mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit.

Përshkruani hollësisht të ardhurat për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura personale, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë. Përcaktoni emërtimin e institucionit, organizatës apo aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrit publik, statusi, objektin e veprimtarisë së organizatës, funksionin, natyrën e angazhimit, nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave neto të krijuara, në lekë apo në valutë

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

"Periodik/Vjetor"

DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË

Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit, si dhe detyrimet e lindura gjatë vitit te deklarimit, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.
Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve personi i lidhur ka detyrime financiare, janë fusha konfidenciale.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë. Për kreditë bankare shumën e kredisë (principal), kohëzgjatjen (muaji/viti) dhe kësti mujor, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit (Principal + interes)	Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit (Principal)

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

"Periodik/Vjetor"

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

